

## KUR ETNIKËT TREGOJNË: SHQA,-U NDËR SHQIPTARË

### 1. Qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës\*

Ky studim ngërthen në mënyrë të thukët historinë e brendshme të njërit prej emrave etnikë më të hershëm në nomenklaturën e onomastikës shqiptare. Është fjala këtu për etnikun e huaj [= exonym(e) ~ shq. ekzonim]: shqa,-u ~ sh. shqe,-të, i cili gjëllin sot e gjithë ditën në ligjërimin e thjeshtë kryesisht si shenjues me kuptimin përbledhës “sllav (i jugut); sllavisht-folës”, e që të paktën qysh prej gjysmës së qindveçarit të fundit nuk duket të jetë përfshirë më si zë i veçantë në fjalorët shpjegues, apo në ata dyguhësh të shqipes<sup>1</sup>. Kjo lënie “pas dore” mund të tumiret fillimisht me faktin gjuhësor, se në shqipen letrare të përpunuuar, e që këtej edhe në shqipen e folur, ka depërtuar e zënë vend në përdorim me kohë një emërtim i huaj (= internacionalizëm) më shprehës, pikërisht emri/mbiemri sllav “sllav, sllavisht-folës”<sup>2</sup>. Megjithatë duket të ketë pasur, pas gjase, edhe një arësyet etike që ka motivuar mënjanimin “e ndërgjegjshëm” të etnikut shqa prej fjalorëve akademikë të shqipes. Siç ka ndodhur e ndodh jo rrallë me emërtimet popullore të popujve fqinjë, edhe ky emër etnik ka përjetuar në kohë, sidomos në

\* Dëshiroj të shpreh këtu falenderimet e rastit për ndihmën e dhënë gjatë konsultimit të indormacionit shtesë mbi situatën gjuhësore në trevat shqiptare të Maqedonisë dhe Kosovës dr. Lumnije Jusufin (Munih) dhe dr. Besim Kabashin (Erlangen). Gjatë mbledhjes dhe përpunimit të materialit gjuhësor në trevat e diasporës arbëreshe në Italinë e Jugut dhe në Sicili nuk më mungoi as këtë radhë ndihma e çmuar e kolegëve dhe miqve të mi prof. Francesco Altimari-t dhe prof. Matteo Mandalá-s. Megjithatë, për çdo paqartësi ose dyshim që mund të shfaqet gjatë leximit të të dhënave përkatëse në tekst, është shkruesi i këtyre radhëve ai që mbart mbi vete përgjegjësinë shkencore.

<sup>1</sup> Regjistrimet e fundit, të cilat gjithsesi nuk i referohen emërtimit përkatës, por çerdhes së tij leksikore, i lexojmë në FGJSH (Tiranë 1954 540: *Shqenia/Shqeria* f. „emër përbledhës për sllavët“; *shqenisht/shqerisht* ndf. „sllavisht“). Si njësi leksikore më vete *shqa* gjen vend në glosarët dialektorë ose në fjalorët e fjalëve të tralla; shih MURATI 2003 154: *shka*.

<sup>2</sup> *Sllav* m. „Pjesëtar i një grapi popujsh me gjuhë të afërta indoevropiane, që banojnë kryesisht në Evropën Lindore (rusët, ukrainasit etj.), Perëndimore (polakët, çekët, sllovakët etj.) dhe Jugore (serbët, kroatët, sllovenët, maqedonasit, bullgarët“ (FGJSH 2006 972). Ky internacionalizëm ka mënjanuar edhe në gjuhë të tjera evropiane nga përdorimi emërtimin e mëhershëm popullor për “sllav (i jugut)”; khs., ndër të tjera, it. *slavo* pranë <sup>1</sup>*schiavo* – *schiavone* (LUI t. XX, Roma 1978 266: *schiavo*; 267: *sohiavone*; BATTAGLIA t. XVII, Torino 1994 999: *schiavo*<sup>2</sup>; *schiavone*<sup>3</sup>).

trevat anësore në veri dhe në lindje të hapësirës kompakte shqipfolëse (: në Mal të Zi, në Kosovë, në Serbinë jugore, në Maqedoninë veriore dhe perëndimore), sipas rastit dhe rrëthanave historike-kulturore ku më shumë e ku më pak një konotacion të theksuar negativ<sup>3</sup>.

Sigurisht që synimi ynë në këtë studim nuk është assesi të qëmtojmë arsyet apo përsiatjet e mundshme, të cilat kanë motivuar njërin apo tjetrin leksikograf ta shmangë këtë njësi prej fondit leksikor të shqipes letrare, e për tepër as të gjykojmë ndërhyrje të mundshme të asaj natyre. E në rast se heqim dorë nga çfarëdo lloj paragjykimi apo ngarkese emocionale<sup>4</sup> dhe i përkushtohemi tërësisht thjesht dhe vetëm shqyrtimit diakronik të gamës kuptimore dhe përdorimeve të këtij etniku në arealin gjuhësor shqipfolës, duke përfshirë këtu edhe enklavat historike të diasporës shqiptare, atëherë do të na befasojë një thesar vërtet i çmuar variantesh formale dhe nuancash kuptimore me shtrirje dialektore ndryshme, i cili na lejon ta cilësojmë këtë emër etnik si njërin ndër gurët orientues në rindërtimin retrospektiv të fazave të mëhershme që ka përshkuar procesi i ngjizjes dhe i zhvillimit të etnogjenezës shqiptare.

Pas një paraqitjeje të përbledhur të materialit dokumentar dhe të dhënave dialektore rrëth përhapjes dhe përdorimit e këtij etniku së bashku me çerdhen e vet leksikore në gjithë trevat shqipfolëse, do të përqendrohemë në hetimin e prejardhjes (: etymologie-origine) si edhe në disa pamje të shndërrimeve kuptimore që ka përjetuar ky etnik ndër shqiptarë në kohë dhe hapësirë. Në pjesën përbyllëse do t'i përkushtohemi tërësisht çështjeve që kanë të bëjnë me historinë e brendshme të këtij etniku (: etymologie-histoire des mots) në shqipe, çka parakupon një bashkërendim pune ndërdisiplinore ndërmjet vëzhgimit të mirëfilltë gjuhësor-historik dhe hulumtimit të etnogjenezës së popullit shqiptar, përkatësisht të marrëdhënieve të tija afatgjata me fqinjët sllavë, marrëdhënie këto që përgjatë aksit kohor zgresin deri në prag të mesjetës së hershme.

## 2. Shtrirja dialektore, përdorimi dhe çerdhja leksikore përkatëse

### 2.1. Gjendja gjuhësore në hapësirën kompakte shqipfolëse

Ky emër etnik duket të jetë në përdorim thuajse gjithkund në hapësirën kompakte shqipfolësë<sup>5</sup>, madje me një larmi variantesh formale që të

<sup>3</sup> Një tjetër procedurë ndeshim p.sh. në DLR (1978 XI 44: *scheau*).

<sup>4</sup> Me një ngarkesë emocionale të theksuar, por shkencërisht të pamotivuar, janë përshkruar p. sh. zérat përkatës tek AHMETAJ (1996, 282; 2002 290v.).

<sup>5</sup> Për situatën gjuhësore në arealin dialektor të toskërishtes jugore (labërishte dhe çamërishte) shih § 2.1.1.

kujtojnë veprimin e një numri dukurish dialektore, të tilla si zhvillimi i grupit bashkëtingëllor \*/Kl/, apo rrugët e përfimit të gjatësisë historike të zanoreve në arealin gjuhësor të shqipes, khs. Geg[ënishte] ver[i]per[ëndimore] shkjā-u ~ sh. shkjē-t; geg. ver. Lind[ore] shkā-u ~ sh. shkije-t; geg. jug[ore] shqā-u ~ sh. shqē-t; tosk[ërishte] ver. shqa-u ~ sh. shqe-t.<sup>6</sup>

Për sa i takon paletës kuptimore që sendërton ky emërtim, vërejmë fillimisht se ai përdoret:

me përhapje të gjerë si i vetmi emërtim popullor sidomos me kuptimin përbledhës “banor sllav (i jugut/ Ballkanit); sllavishtfolës” (Kristoforidhi 1903 339; Bashkimi 1909 424; Mann 1948 477, 495 etj.); dhe

me përhapje të kufizuar dialektore – sidomos në trevat anësore të hapësirës kompakte shqipfolëse – edhe për të dalluar fqinjin sllavojugor përkatës, si p.sh. “malazias” në veriperëndim (Ahmetaj 1996 282), “serb” në verilindje (~ në veri të Kosovës dhe Serbinë e Jugut), përkatësish “bullgar [= maqedonas – B. D.]” në lindje të trevave shqiptare (Hahn AS III 1853, 210; Weigand 1914 83, Barić 1950 71 etj.)

Një hulumtim më të detajuar kërkon përdorimi i mundshëm i fjalës me kuptimin “shërbëtor; skllav”, i cili shfaqet rrallë dhe i kufizuar në proverba ose shprehje popullore, khs.: më mundo si shkjanë e më duaj si vëllanë “kështu i thotë kali të zotit, d.m.th.: më detyro të punoj sa të duash, por më jep të ha mirë.” (Leotti 1937 1370)<sup>8</sup>.

Një përbërës kuptimor të rëndësishëm, që është i lidhur ngushtë me nocionin “sllav; sllavishtfolës” e ndeshim në fushën e terminologjisë popullore kristiane, ku shqa shenjon kryesisht një “pjesëtar të kishës ortodokse sllave” (khs. Bashkimi 424: <shkia> “slavo scismatico” pranë <shkienii-a> “nazione slava e religione greco-scismatica”); ndërsa me përhapje të ngushtë krahinore një “pjesëtar të kishës ortodokse autoqefale sllave”, si p.sh. “serb

<sup>6</sup> Forma të tjera variante nëndialektore janë edhe: *shgeh-u* (MANN 1949 495); (emërore e shqar) *shkiavu* (GUAGLIATA 1845 45: <sckiávu>); *shja-u* ~ sh. *shije,-t* (MURATI 1998 169; 2003 154). Shih më poshtë (§ 2.2.1) edhe variantet që dëshohen në të folmet arvanite të Greqisë.

<sup>7</sup> Kështu p.sh. në vendbanimet shqiptare të Maqedonisë Perëndimore bëhet gjuhësisht qartë dallimi midis *shka*, *shia* “fqinji sllavo-maqedonas” dhe *bugar* “bullgar”; khs. *n'kōh t'bugarve* [= kur kjo zonë ishte pjesë e shtetit bullgar]” (kumtim i L. JUSUFI-t).

<sup>8</sup> Në regjistrimet e bëra në shkrimet e Mati LOGORECI-t: *shkjeni* “skllavëri”dhe *shkjenoj* “skllavëroj” (shih MANN 1949 481) kemi të bëjmë pas gjithë gjasash me një huazim kuptimor apo kalk gjuhësor që ka në bazë modelet ekzistuese në italishtë. Sipas SKOK-ut (1971-3 282), fjalë *shka* si formë e zgjeruar <çkavac> përdoret në argonë e qeramikë-punuesve të Prishtinës krahas kuptimit “serb” edhe me kuptimin “njéri”. Një situatë e ngjashme vërehet edhe në argonë e muratorëve shqiptarë në Bracigova (Rodope), ku shenjuesi *shkjau* përdoret me kuptimet “bullgar” dhe “njéri” (SKOK ibid.).

ortodoks” (Krstić 1987 113: “pravoslavac Srbin”), “bullgar – ortodoks” (Mann 1948 494: “Bulgar, orthodox Slav” etj.). Përkatësia fetare ka ndikuar në kohën tonë që grupe dygjuhëshe në Maqedoninë Perëndimore (p.sh. në zonën e Malësisë së Rekës), të cilat në fakt kanë (pasur) shqipen si gjuhë amtare, por që i përkasin kishës ortodokse sllave, të dallohen ende në kohën<sup>9</sup> tonë – sigurisht jo (gjithherë) me konotacion negativ – me emrin etnik shqa.<sup>9</sup>

Ky përbërësi i fundit kuptimor të bie në sy sidoos në përmendoret e vjetra të shkrimit shqip (në arealin kulturor katolik të Veriut), ku shqa qysh nga fundi i shekullit XVII përdorej pas gjase edhe si emër përbledhës në kuptimin “sllavishtfolës”. Khs. p.sh. te Bogdani (1685 Të primitë):

[...] veçë ju lutshë të më shtampohej libri, ashtu qì kur të kthenje prej dheut sinë të keshe nji qirë ndezunë në dorë, për të ndritunë atë të vobek dhë t’Arbenit e të Sherbisë, i sillë, e madhe pjesë flet arbënisht, tue kjanunë dalunë dheut së Arbënit e mbiellë Shëjtënë Fë ndë dhë të Despotit: prashtu shkietë për anonomasi Fësë Katolike i thonë arbanaska vera.]<sup>10</sup>

Në tekste të kësaj natyre nuk mungon gjithsesi as prirja, që – sipas kontekstit gjuhësor – përdorimi i etnikëve t’i mëshojë më fort nënveftësimit deri në mohim të plotë të konfesionit tjetër, përkatësishët të ortodoksisë sllave dhe greke në përqasje me atë katolicizmin romak, ose të besimit/fesë tjetër, përkatësishët të islamit, pa marrë parasysh këtu aspak identitetin etnik-gjuhësor të mirëfilltë të besimtarëve. Këtë rrethanë e përjetojmë më së quarti në tekstin e përkthyer shqip të akteve të Kuvendit të Arbënit (Mërqinje 1703), ku emërtimi shqa përdoret me kuptimin “skizmatik”, madje edhe “heretik”, përkatësishët “besimtar fals”, duke ngërthyer në vetvete kryesisht atë të krishterë shqipfolës që i ishte bashkuar kishës ortodokse sllave, sikurse quhej grek dhe urum (< turk. (u)rum “grek”) i krishterë shqipfolës që i përkiste kishës ortodokse greke, përkatësishët turk gjegjësi mysliman, khs.:

[....] qi tue ndiekune kalendarin e zâkonin e griqet, ndo te shkivet, qësne mbas shpine zâkonin e kalendarin e Ghergurit Pape ...” (f. 30)<sup>11</sup>;

[...] qi duoli prej se shkuemit e prej se perziemit me shkiëte e me urumte, e të

<sup>9</sup> Kumtim i L. JUSUFI-t.

<sup>10</sup> (Rip[rodhimi] dipl[omatik]) <... vece jù lutsce te me shtampohej Libri, asctu chi cur te kçegne prej çeut sine te Kefce gni Chirij ndecëune ndore, per te ndrittune ate te vobek çhee t’ Arbenit, e te Scerbijse, i filli, e maçë pjesë flet Arbenist, tue kjanune dalune çeut se Arbenit, e mbille Scenjtene Fee nde çhee te Despotit: prastu Schiete per anonomaffi Feesse Cattoliche i çësone arbanasca vera.>

<sup>11</sup> (Rip. dipl.) <.... chi tue ndiecune kalendarin, e saaconin e Gricchiet, ndò te Schievet; chiesine mbas scpine saaconin, e kalendarin e Ghergurit Pape ...” – (lat. Originaltext) <Aberrant enim Fideles montana incolentes; qui nonnullas Sanctorum Slemnitates Calendarii Gregoriani relictâ metodo, tantum Græcorum more , & Calendario concelebrant: ...>

mbâne festat sekundrese zâkoni e esapi i Romese.| (f. 31)<sup>12</sup>;

|Veçe asht zâkoni i urumit, ndo t' shkiaut me mos pagezuem mbe te madhe nevoje, veçe priftinit e tyne.> ... <Kinë te derremohet prej katolikish ajo pune, qì mizori i mocimi pâ pushuem ndeper goje te shkievet arretoj per te keq te shpirtit.| (f. 39)<sup>13</sup>;

|Aspak asht per t'u duruem zâkoni i ndy em me zâne per kumpâr turit, ndo shkiëte| ... |Veçe shkiëte mbe te njefuni te kesaj pune ecene troqe-mboqe, tue prishune krushqîne si i pelqen veti, jo tuk ep ligja.| (f. 40)<sup>14</sup>:

|Po të ruhen barîte e shpirtinavet per pune te kumetrise, nde mos u skandalizoft shkiau, qì asht skismatik, qì kâ per zâkon me vum barra te randa travet e huoje, po me gishti te vete s'do me e luitune.| (f. 45)<sup>15</sup>;

|Pr'ata të pafëtë turit, heretikit, shkiëte, urumtë e të skomunikuemit, qì tue kienë gjallë, as e mbânë Kishënë për Amë e as Hyjin për Atë, janë për të i larguem prej pushimit së vorrevet ...| (S. 88)<sup>16</sup>.

<sup>12</sup> (Rip. dipl.) <... ci duoëi prej se fckuemit, e prej se perciemit me schieete, e me Urumte, e te mbaane Festat secundrefë saaconi, e estapi i Romefë.> – (lat. Originaltext) <... quæ ex schismaticorum commercio, & familiaritate irrepsit, prudentibus monitis, ac salutaribus præceptis tollendam current, Romanosque ritus in Festorum celebratione ad unguem satagant exequendos.>

<sup>13</sup> (Rip. dipl.) <Vece asct saaconi i urumit, ndò t' Schiaut me mos pagheevem mbe te maçë nevoje, vece Priftinit e tñne.> ... <Kinë te derremohet prej Cattolikisc ajò pune , chi mëorë i moccimi paa puscivem nde per goje te Schievet arretoj per te kech te Scipritit.> – (lat. Originaltext) <Schismaticorum quippe perniciosa lex est, parvulos urgente quoquè necessitate , non nisi à Sacerdote baptizandi.>

<sup>14</sup> (Rip. dipl.) <Aspak asct per t'u duruem saaconi i ndgëm me saane per cumpaar Turit, ndò lckieete ...> ... <Vece Schieete mbe te gnefuni te keffaj pune ezzene trocchie mbocchie tue prisciune kruschiine si i pelchien veti iò tuk epp ligia.> – (lat. Originaltext) <Detestabilem quoquè consuetudinem, Infideles, vel Schismaticos admittendi ad Patrini munus obeundum ...> ... <Schismaticorum quippe est, in suppeditandis gradibus caligare, & qui carnalis consanguitatis vincula in matrimonii copulatione effirmata arbitrii licentia disrumpere non desinunt ...>

<sup>15</sup> (Rip. Dipl.) <Po te ruhen Bariite e Scipritinavet per pune te Cummetriile, nde mos u fckandalieoft Schiau, chi asct Schismatik, chi kaa per saacon me vum barra te randa travet e huoje, po me ghifeti te vete s do me e luitune.> – (lat. Originaltext) <Covenant autem Pastores, ne dum ad alios quoquè jura cognitionis extendunt, ne erronea Schismaticorum scandalizetur infirmitas, alligare videantur onera gravia, & importabilitia, digito autem suo nolunt ea movere.>

<sup>16</sup> (Dipl. Repr.) <Pr'ata te paafeete Turit, Heretichit, Schieete, Urumte, e te fcomunicuemit, chi tue kiene gjalle, as e mbaane Kiscene per Ame, e as Hjzin per Ate, Jane per te i larguem prej pulsimit se vorrevet ...> – (lat. Originaltext) <Quapropter Infideles , Hæretici, Schismatici, publicè excommunicati, qui viventes, nec Ecclesiam Matrem, nec Deum habuerunt Patrem, ab Ecclesiasticæ sepulturæ refrigerio ...>

Në rrjedhë të kohës, organizimi i popullsisë shqipfolëse në katër grupime fetare, d.m.th. në shqa “ortodoks-sllav” pranë latin “katolik-romak”, turk “mysliman” dhe grek “ortodoks-grek”<sup>17</sup> erdhi duke u bërë një faktor destabilizues në matriksin e kulturës etnike shqiptare, madje në një masë tillë, saqë në gjysmën e dytë të shek. XIX, shi gjatë procesit të zgjimit të vetëdijes kombëtare, komponenti fetar u mënjanua krejtësisht e në mënyrë të vetëdijeshme nga programi kulturor-ideologjik i lëvizjes së Rilindjes Kombëtare<sup>18</sup>.

### **2.1.1. Vendi i veçantë i arealit dialektor të toskërishtes jugore**

Shkruesi i këtyre radhëve nuk ka mundur deri sot të qëmtojë burime dokumentare të sigura që dëshmojnë përdorimin e këtij etniku edhe në area lin dialektor të toskërishtes jugore, ku shqa pritej të përdorej në dy variante kryesore: \*shqa në labërishte, përkatësisht \*shkla në çamërishte. Përgjigja negative e informantëve ndaj pyetjes së drejtpërdrejtë dëshmon se shqa nuk gjëllin në këto treva si ekzonim. Këtë përfundim e tumir deri diku edhe rrethana, që kjo zonë nuk kufizon në kohën tonë me treva anësore sllavisht-folëse. Gjithsesi, prania e dikurshme e këtij emri mund të mëtohet me pak a shumë siguri, në rast se marrim parasysh ato gjurmë të rralla që ruhen në çerdhen leksikore të fjalës, ku ndeshim ende sot ndonjë njësi të prejardhur me kuptim të tejbartur, deri përcmues. Të tilla janë derivatet e përfshira nga një bazë e përbashkët lab. \*shqe(r)- ~ çam. \*shkli-, si p. sh. a) ndërtimi misional çam. shklirë f. (fjalë përcmuese për një) “femër që kryen marrëdhënie seksuale jashtë martese; grua e përdalë” ← \*\*(grua) sillave”<sup>19</sup>, dhe b) fjalë të prejardhura, të regjistruara për toskërishten jugore, të tilla si: shqerëzohem fol. “humbas nderin; më prishet nderi; më pëlqet cipa”, shqerëzim m. “të rënë nga nderi; të plasur cipa e turpit, imoralitet” etj.<sup>20</sup>

### **2.2. Gjendja në diasporën historike shqiptare**

Një situatë të ngjashme na kumton diaspora historike shqiptare, ku shqa dëshmohet thuajse gjithkund si ekzonim. Kështu p.sh., ai gjëllinte në

<sup>17</sup> Shih më hollësish B. DEMIRAJ 2005 15vv.; nga letërsia katolike e shekullit XIX khs. ndër të tjerë GUAGLIATA 1845; RADOJA 1876. Shpesh ndodh edhe barazimi “i përkatësisë fetare kombëtare” brendapërbrenda ortodoksisë, khs. ROSSI 1866: <schkaa,-u, skiiáa-u, scka,-u “greco, eretico, scismatico”>.

<sup>18</sup> Khs, ndër të tjerë, P. Vasa në memorandumin e tij në vargje: „O moj Shqypni“ (1878): „/Sa thon: kam fe / sa thon: kam din / njeni: jam turk / tjetri: latin / do thon: jam grek / shkje: disa t’jer / porjeni vllazën t’gjith mor t’mjer!“ Më hollësish për këtë Elsie (1997 193).

<sup>19</sup> Informante: E. SADIKU – krahina e Çamërisë, 70 vjeç.

<sup>20</sup> P. TASE (1941 174; 2006<sup>2</sup> 183); shih edhe § 2.3.

shek. XVIII tek shqiptarët e Sremit, khs. shkje “rac, serb i shpërngulur në Srem” (Windisch 1782 85: <Schkje = ein Ratz>); ndërsa në kohën tonë atë e ndeshim rregullisht në enklava të ndryshme shqipfolëse, si p.sh. a) në Kroaci (Zarë/Zadar) shkjô,-au ~ sh. shkê-t “serb” (Krštić 1987 113), b) në Bullgari (Mandrica) shkla /shqa,-u ~ sh. shkle / shqe,-t “bullgar” (Shuteriqi 1965 167; Sokolova 1983 39), si edhe c) në Ukrainë (Karakurt) shkla “bullgar”<sup>21</sup>

## 2.2.1 Pozicioni i veçantë i enklavave shqiptare në Greqi dhe në Italinë e Jugut

Gjendja gjuhësore në diasporën e mëhershme shqiptare në Greqi dhe në Italinë e Jugut është parashikuar në një rubrikë të veçantë, meqenëse këtu kemi të bëjmë me një shmangje të theksuar në përdorimin e kësaj njësie, përkatësisht të çerdhes së saj leksikore. Kështu p.sh., tek arvanitasit e Greqisë ky etnik është në përdorim sot e gjithë ditën, por me të ata dallojnë fqinjët e tyre grekë. Këtë rrethanë e vëren së pari gjuhëtarë slloven Franz Miklosich (1870 33, duke iu referuar Reinhold-it 1855 [Leksiku] 31: shkla), kur shkruan, se: “të bie në sy fakti, që shqiptarët e Greqisë me të njëjtën fjalë emërtojnë grekët.”<sup>22</sup>; khs.: arv[anitishë] e Gr[eqisë] shkla,-u ~ sh. shkle,-të “grek njëjuhësh [= që flet vetëm greqisht]; jo-arvanit” (Sasse 1991 107) pranë shklja,-u dhe skla,-u “id.” (Jochalas 2002 615)<sup>23</sup>.

Një tjetër rrethanë ndeshim tek arbëreshët e Italisë së Jugut dhe të Sicilisë, ku kjo fjalë duket se nuk është më në përdorim. Por, ashtu si në rastin e shqyrtuar për arealin dialektor të toskërishtes jugore (§ 2.1.1.), edhe këtu ky emër etnik duhet të jetë bjerrë nga përdorimi në rrethana të caktuara historike-sociale. Për këtë mjafton të mbajmë parasysh që në këtë areal gjëllijnë ende dy njësi të prejardhura nga e njëjta bazë \*shkla-/shkle- ~ \*shqa- : arb[ërishte] e It[alisë] (Platten) shklan mb. “që nuk flet arbërisht”<sup>24</sup>, si edhe (dial.) shklerisht pranë sklerisht, shqarisht ndf. “(flet) në mënyrë të pakuptueshme; në një gjuhë të huaj [= jo arbërisht]” (shih më poshtë § 2.3).

## 2.3. Çerdhja leksikore e fjalës

<sup>21</sup> Fjala është për fqinjët që i përkasin pakicës bullgare në fshatin e tyre (Karakurt). Shih për këtë ISLAMI (1965 168: „Ata quhen arnautë dhe bullgarët prej tyre quhen *shkla* (sllavë“). Këto të dhëna u vërtetuan edhe nga etnografi Aleksander NOVIK (St. Petersburg), i cili ka kryer ekspedita etnografike në terren.

<sup>22</sup> Një gjendje të krahasueshme paraqit edhe trajta e MIKLOSICH-it (po aty: *shkina* „vlahinja, (sërpkinja)“) me referimin tek VUK-u (12,7 [i pa verifikuar dot prej meje – B.D.J.]).

<sup>23</sup> Të tjera forma variante (dialektore) tek arbëreshët e Greqisë: *sklja* (JOCHALAS 2002 615: *aj isht sklja, nëk di arvanite*; 626); sh. *shkla* (SASSE 1991 107).

<sup>24</sup> Kumtim i Francesco ALTIMARI-t: *shklan* “njeri që nuk flet si na, që nuk e di arbërishten”.

Ndërtimi misional, përkatësisht i gjegjësit të gjinisë femërore, së bashku me ndërtimet fjalëformuese që janë tipike për çerdhet leksikore të emrave etnikë dëshmojnë gjithkund një timbër të ndryshëm të zanores së rrënjes, pikërisht një /e/ ose /i/ metafonike, khs.:

Ndërtimi misionale: geg. shkîn,-a f. "sllave, grua ortodokse sllave" (Jungg 1895 130: „greca scismatica“; Truhelka 1899 63: „Orthodoxe“); shkinë,-a (Bashkimi 1908 425; Cordignano 1934 195: "donna slava di religione scismatica"; Mann 1948 481: "slav girl or woman, Serb"<sup>25</sup>, po kështu me bazë të zgjeruar: arb. Kr. shkînk,-a f. (Krstić 112: "srpkinja"), geg. Shqinkë,-a f. (Kristoforidhi 1903 40; Mann 1948 496: "Slav girl or woman, orthodox woman, Bulgarian"); tosk. ver. (dial.) shkirë,-a pranë shqirë,-a; arb. Bullg. shklirë,-a pranë shqirë,-a (Shuteriqi 1965 167; Sokolova 1983 39), arb. Ukr. Shklirë,-a "bullgare". Këtu bën pjesë edhe çam. shklirë "grua e përdalë" (shih § 2.2).

Emra abstraktë/kolektivë: geg. shkjeni,-a f. "sllavët; ortodoksia sllave/greke" Bashkimi 1908, 424: "Nazione slava e religione greca scismatica"; Weigand 1914, 83: "Slaventum; Orthodoxie"; Cordignano 1934, 195: "gli slavi ortodossi" etj.);

I njëjtë formim del edhe si emër vendi në treva të ndryshme të banuara (dikur) nga sllavët brenda dhe jashtë hapësirës jetike shqipfolëse: a) "Sllavonia": geg. ver. Shkjeni,-a (Blanchus 1635 33: <Illyris, Schiavonia Schienia>, 144: <sclauonia Schienia>); tosk. (= arb. It.) Shkeri,-a (Chetta 1763: <Schiavonia Schieria>); b) "Serbia": Shkeni,-a (Miklosich 1870 33: <ške-nija Serbien>); c) "Bullgaria (+ Maqedonia, B. D.)": geg. Shkeni,-a, tosk. Shkeri,-a (Hahn 1854 121 "Bulgarei"; Kristoforidhi 1903 340: "οἱ Σκύθαι, οἱ Σλαύοι, οἱ Βούλγαροι" [= Skithet, Sllavët, Bullgarët]), pranë Shklerlik,-u "Bullgaria" tek arbëreshët e Bullgarisë (Shuteriqi 1965 167); këtu bën pjesë pa dyshim edhe d) Shkeri,-a "krahinë në Shqipërinë Jugore midis Përmjetit (në lindje) dhe Kolonjës (në perëndim)" (fesh 1985 1038; Tase 20062 183).

Ndërtim ndajfoljor: a) "sllavisht": geg. ver. shkinisht (Jungg 1895 130: "alla slava"); shkienisht, shkjenisht (Truhelka 1899 79 "nashk"; Bashkimi 1908 425: "alla slava"; Cordignano 1934 195); b) "bullgarisht": geg. shqenisht pranë tosk. shkerisht (Hahn 1854 121; Kristoforidhi 1903 340: "Σκυθστί, Σλαυιστί, Βουλγαριστή"); arb. Bullg. shklerisht "bullgarisht" (Sokolova 1983 39); c) "serbisht": geg. shkinisht (Mann 1948 481: "Serbian [or Slav] fashion"); d) "kroatish": arb. Kr. shkenisht (Tagliavini 1937 253: "in croato": <A di shkenisht? Sai il croato?>); këtu përfshihen edhe e) "greqisht" tek arvanitasit në Greqi: shklerisht(e) pranë sklerishte (Jochalas 2006 388; Di

<sup>25</sup> Këtu edhe <shkina vlahinja srpkinja> (VUK 12 7) tek MIKLOSICH në vendin e cituar.

shklerisht? = Ξέρεις ελληνικά?; 2002 626: Aij di vetëm shklerishte = Αυτός ξέρει ελληνικά; Nashtinë i thomë sklerishte = Τώρα τα λέμε ελληνικά); dhe f) “në një gjuhë të huaj” (= jo arbërisht) tek arbëreshët në Italinë e Jugut: shklerisht pranë sklerisht e shqarisht “në një gjuhë të huaj (= jo arbërisht)” (kumtime të F. Altimari-t dhe A. Bellusci-t); po kështu edhe shprehja (San Cosmo Albanese) flet lëtisht e shklerisht “ai flet krejt në mënyrë të pakup-tueshme, d.m.th. jo arbërisht” (N. Scaldaferrri – me korrespondencë).

Emra prejndajfolorë në kuptimet a) “gjuhë sllave”: shkjenishte, shkjeniste,-ja f. (Bashkimi 1908 425: “lingua slava”; Cordignano 1934 195); b) “bullgarisht” geg. shqenishte, tosk. shqerishte (Kristoforidhi 1903 340: “ἡ Σκυθική, ἡ Βουλγαρική [γλῶσσα]”).

Formime të tjera me prejardhje: geg. qendr. (lindje) shkineshkë,-a “pulë me pupla të zeza” (Murati 1998 165); geg. ver. shkjenim, -i m. “ortodoksi sllave; (fig.) skllavëri” pranë shkjenoj fol. “skllavëroj, shfrytëzoj” (Mann 1948 481: me referim te Mati Logoreci – shih shën. 9; shih §§ 2.1.1; 2.2.1).

### 3. Shqa në fokusin e etimologjisë dhe të etnolinguistikës

#### 3.1 Origjina: huazim nga greqishtja bizantine apo latinishtja e mesme?

Përhapja mbarëdialektore e këtij emri etnik në spektrin e tij kuptimor, së bashku me çerdhen e vet leksikore dëshmojnë së pari se kemi të bëjmë në këtë rast me një njësi të vjetër në leksikun e shqipes. Përqasja formale e larmisë së varianeve dialektore na lejon të rindërtojmë pa vështirësi një bazë të përbashkët \*/ʃklā-/ (</sklā-/ <\*/sklaw-/ ~ sh.\*ʃklē-/ <\*/sklē-/ <\*/sklawi/ <\*/sklaw-i/), e cila mund të rrjedhoret formalisht qoftë prej greqishtes bizantine çkláþoç (~ sh. çkláþoi: Miklosich 1870 33), qoftë prej latinishtes mesjetare sclavus (~ sh. sclavi: Meyer 1891 410). Në albanologji, sikurse edhe në hulumtimet ballkanike mbështetet gjithsesi mendimi i mjeshtrit të etimologjisë shqipe<sup>26</sup>, i cili syzon këtu një huazim latin, duke e mbështetur këtë me faktin, që lat. mes. sclavus është burimi i njësisë gjegjëse edhe në gjuhët romane të Ballkanit<sup>27</sup>. Në sqarimin e çështjes së origjinës fiton rëndësi edhe hetimi i çerdhes leksikore të fjalës, bash ndërtimi misional, i cili ka qëndruar deri sot larg vëmendjes së studiuesve. Variantet e shumta dialektore të dëshmuara: geg. shkinë, shqinë, tosk. shqirë, shklirë f.

<sup>26</sup> Shih së fundi OREL, 2000 432. Më hollësishët për përhapjen e formës latine shih SKOK (1971-3 281v.) dhe VASMER REW 656v.

<sup>27</sup> Shih për këtë sidomos SKOK 1934 181vv.; për emrin shqip dhe gjegjësin rumun shih MIHĂESCU (1978 236, 355) dhe së fundi më hollësishët VĂTĂCESCU (1997 437); për gjegjësen dalmate dhe për përhapjen e fjalës/bazës latine në vendet romane shih ndër të tjerë MEYER-LÜBKE (1935 104):

“(grua) sllave” (shih § 2.3), mundësojnë ndërtimin pa vështirësi të një baze të përbashkët paradialektore: shq. \*/sklawinā/, e cila nuk mund të shpjegohet ndryshe, veçse si një huazim i drejtpërdrejtë prej lat. mes. sclavina.

Lidhur me kohën e përfstimit të këtij huazimi në shqipe mund të shtojmë gjithashtu, që ndërndërrimi i zanoreve /a/ ~ /e/ (metafoni) brenda paradigmës ekzistuese së fjalës, khs. nj. shqa ~ sh. shqe, si edhe dukuria dialektore e rotacizmit \*/-n-/ > tosk. /-r-/ në format femërore gjegjëse bëjnë të zgresim pa vështirësi në fazën e fundit të ndikimit latin në shqipe, pikërisht në një periudhë aty rreth shek. VI - VII, kur këto dukuri vepronin rregullisht në mbarë gjuhën (: metafonia), përkatësisht në njërin dialekt të saj (:rotacizmi)<sup>28</sup>. Përcaktimi i kronologjisë (absolute) të huazimit me mjete gjuhësore përkon kështu katërçipërisht me faktet historike, shi me kohën, kurtributë e sllavëve të jugut (lat. Sclavi, Sclaveni ~ gr. biz. Σκλαυνοί, Σκλαβηνοί; Σκλάβοι)<sup>29</sup> depërtuan në Ballkan, dhe nëpërmjet shtrirjes dhe dominimit të tyre thuajse kudo e gjithkund në gadishull ndryshuan thellësisht marrëdhëni kulturore ekzistuese ndëretnike.<sup>30</sup>

### 3.2. Shndërrime kuptimore

Në rast se zhvendosim tash kahen e hetimit diakronik në spektrin e kuptimeve që gjëzon kjo njësi leksikore në kohën tonë, do të vërejmë se ndikimi i latinishtes së mesme (≤ greqishtes bizantine) mund dhe duhet të ketë vepruar në një periudhë bukur të gjatë, meqë përgjatë aksit kohor atë arrijmë ta izolojmë në të paktën tre përbërës kuptimorë, e pikërisht: a) “sllav”: si emër me kuptim përbledhës për një pjesëtar çfarëdo të tribuve sllave-jugore që u dyndën dhe u përhapën në Ballkan në shek. VI-VII; në bashkëlidhje me këtë b) “pagan” në kuptimin “jo-kristian”; e më vonë i kombinuar edhe me kuptimin c) “skllav” si një “person pa të drejta dhe pa plang” (shek. IX – XI).<sup>31</sup>

Të tre këta përbërës semantikë, në rrjedhë të kohës e në përputhje me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore dhe kulturore-fetare, i janë nënshtruar në gjuhën popullore ku më shumë e ku më pak ndryshimit kuptimor. Kështu për shembull vjen e rrëgjohet gjithnjë e më shumë përbërësi kuptimor i dikurshëm për “skllav”, i cili dëshmohet në kohën tonë vetëm si relikt gjuhësor me kuptimin derivat “shërbëtor” (shih § 2.1/c). Përdorimi me

<sup>28</sup> Shih Sh. DEMIRAJ 1985 100vv.

<sup>29</sup> Hollësisht për këtë KORTH 1970 151vv.

<sup>30</sup> Në mënyrë të detaujar për këtë WEITHMANN 1997 53vv., Curta 2001. Për marrëdhëni shqiptare-sllavojugore në historinë e Ballkanit shih SKOK 1924, 107vv.; SVANE 1992.

<sup>31</sup> Shih, ndër të tjera, KORTH 1970 151v., si edhe SKOK: 1971-3 282.

kuptimin përbledhës për një person me origjinë sllave-jugore ndërndërohet vazhdimisht me banorin fqinj që i përket etnisë sllave malazeze, serbe ose maqedone-bullgare në varësi kjo me fqinjësinë gjeografike-gjuhësore si edhe në bashkëlidhje me zhvillimet sociale-historike të vetë rajonit; khs. shqa = malazez, cernagoras ~ serb ~ maqedon/bullgar (shih § 2.1/a). Përdorimi i dikurshëm i shqa edhe me kuptimin “pagan; jo i krishterë”, i cili nxori jashtë përdorimit në terminologjinë populllore kristiane shenjuesin e mëherëshëm tosk. (i) pégërë, geg. i pégām b. “i papastër, i fëlliur” (< † “pagan, jo i krishterë” < lat. kisht. pāgānus)<sup>32</sup>, erdhi dhe u përdor me kohë, sipas përkatësisë konfesionale ose fetare, me kuptimin “skizmatik, ortodoks; pjesëtar i kishës ortodokse bullgare, përkatësish serbe” madje edhe me konotacion negativ si “heretik” (§ 2.1/b). Ky përbërës i ri kuptimor, që është përdorur gjerësisht sidomos në letërsinë fetare të arealit kulturor katolik të Veriut, duke të jetë një zhvillim i brendshëm i shqipes, pasi nuk ka një gjegjës përkatës në terminologjinë kishtare të vendeve të krishtera (ballkanike).<sup>33</sup>

Pjesa tjeter e kuptimeve të fjalës mund dhe duhet vështruar pa dyshim si rrjedhojë i zhvillimeve të brendshme (dialektore) në gjuhë. Në këto raste të bie në sy sidomos që përbërësi semantik themelor, pikërisht komponenti etnik-gjuhësor “sllav (i jugut)” së bashku me derivatet e veta: ose a) është rrëguar krejtësisht, si është p.sh. rasti në trevat jugperëndimore të hapësirës gjuhësore kompakte shqipfolëse (§ 2.1.1.); ose b) është zëvendësuar me komponentin etnik-gjuhësor “grek, jo-arvanit” në diasporën arvanite të Greqisë; përkatësish c) me atë “jo-arbëresh” në diasporën arbëreshe në Italinë e Jugut (§ 2.2.1).

### 3.3. Shqa në fokusin e historisë së brendshme të fjalës

A mund të shpjegohet kjo situatë “e çuditshme” me faktin që si shqiptarët në trevat jugperëndimore të hapësirës së tyre kompakte ashtu edhe arvanitët në diasporën historike të Greqisë (shek. XIII – XV), përkatësish arbëreshët në diasporën historike të Italisë së Jugut (prej shek. XV) i kishin bjerrë prej kohësh kontaktet e drejtpërdrejta me popullsi sllave?<sup>34</sup>

<sup>32</sup> Më hollësisht për këtë tek B. DEMIRAJ 2002 23vv.

<sup>33</sup> Khs. më sipër (shën. 12-17) pasazhet latinisht prej tekstit original të akteve të Kuvendit të Arbënit (1706).

<sup>34</sup> Shkruesi i këtyre radhëve nuk mbështet assesi tezën e FALLMERAYER-it (1830), sipas të cilit popullsia e sotme greke në pjesën kontinentale të Greqisë, përkatësish në Peloponez, përbëhet në të vërtetë prej sllavësh të helenizuar, edhe pse kjo tezë mund t'i përshtatej fare mirë operacioneve logjike në hullitë e zgjidhjes së këtij problemi. Vështirë se mund të

Për të mëtuar këtë rrethanë si shkak kryesor, mjafton që t'i referohemi thjesht gjendjes së sotme etnike-gjuhësore në krahinat përkatëse. Gjithsesi, përgjigjja pozitive do parë sigurisht vetëm si zgjidhje e pjesshme e një qer-thulli problemor shumëplanësh, të cilin mund ta përbledhim në një pyetje të vetme: Në ç'masë pasqyrohen në historinë e brendshme të ekzonimit shqa marrëdhëniet kulturore ndëretnike midis shqiptarëve dhe sllavëve (të jugut)? Kjo është padyshim një çështje, që për periudhën midis kontakteve të para shqiptaro-sllave në Ballkan (pas gjase prej shek. VI) dhe dëshmisi së parë dokumentare të ekzonimit shqa në analet e historisë së shkrimit shqip (Bogdani 1685)<sup>35</sup> mund të hetohet vetëm në kuadrin e një pune të bashkërenduar ndërsidiplinore, përkatësisht në fushën e etnolinguistikës.

Kështu, në rast se i ngërthejmë së bashku dhe analizojmë nga kjo perspektive të dhënat e mësipërme mbi përhapjen dhe përdorimin e këtij emri etnik me çerdhen leksikore përkatëse (§§ 2 – 3.2), atëherë vëmë re se dallohen qartë disa shtresa të konceptit popullor që mbart shenjuesi shqa:

A) Në hapësirën kompakte shqipfolëse: α) përgjithësisht, d.m.th. përgjatë (gjithë) shtrirjes së saj; dhe/ose β) gjeografikisht e kufizuar, sidomos në zonat anësore të arealit gjuhësor shqiptar. Bëhet fjalë këtu për:

1. α) një emërtim popullor që gjëllin thjesht si emër përbledhës, përkatësisht si etnik, duke shenjuar si i tillë një person apo një bashkësi njerëzish që dallohen si “sllavë” për origjinën e përbashkët etnike-gjuhësore, dhe që bashkëjetojnë me shqiptarë në hapësirën e tyre jetike kompakte ose ndajnë me ta viset kufitare në Ballkanin Perëndimor dhe Qendror; përkatësisht β) një emër etnik, që dallon prejardhjen kulturore-etnike dhe/ose gjuhësore “sllave” të etnive të veçanta sllavishtfolëse në këtë hapësirë, përkatësisht në trevat e saj kufitare: “shqa” = geg. ver.per. “malazez”; geg. ver. lind. “serb”; geg. jug. / tosk. ver. “maqedon (~ bullgar)”.

2. α) një emërtim popullor që dallon në përgjithësi një person a bashkësi njerëzish në përkatësinë e tyre konfisionale si “skizmatikë; ortodoksë sllavë” – sipas rastit edhe me konotacion negativ, pa marrë parasysh patjetër/ gjithnjë identitetin etnik-gjuhësor; përkatësisht β) emërtimin specifik të një personi ose bashkësie njerëzish – zakonisht në fqinjësi – si pjesëtarë të njërsë prej kishave autoqefale ortodokse sllave (malazeze, serbe, bullgare/ maqedone) në Ballkan. Edhe në këtë rast ai përdoret në rrethana të caktuara me konotacion negativ, pa marrë parasysh patjetër/gjithnjë identitetin etnik-gjuhësor;

pranohet gjithashtu edhe mendimi i MEYER-it (1891 410), sipas të cilit *shqa* në zanafillë përdorej te shqiptarët për të shenjuar “grekët ortodokse”.

<sup>35</sup> Më i hershëm në trashëgiminë shkrimore shqipe është emri i vendit *Shkienia* tek BLANCHUS ([=Frang Bardhi] 1635 33: <Illyris, Schiavonia *Shkienia*>).

3.  $\alpha/\beta$ ) një përdorim të rrëgjuar †“shërbëtor, raja”.
4.  $\alpha/\beta$  (geg. + tosk. veri.): një emërtim pejorativ për një person ose grup njerëzish që përqasen me fqinjin “sllav”, si edhe  $\beta$  (tosk. jug.) një /nofkë përcmuese ndaj një personi a grapi personash që kanë humbur nderin (Labëri); ose për një femër që jeton në kundërshti me kodeksin e nderit dhe mënyrën tradicionale të jetesës shqiptare (Çamëri), pa marrë parasysh këtu (të paktën, në kohën tonë) prejardhjen e saj etnike-gjuhësore.

B. Në diasporen shqiptare:

në Greqi: një person apo një grup njerëzish të bashkësisë etnike-gjuhësore (= njëgjuhëshe) greke, d.m.th. jo-arvanitase.

në Italinë e Jugut: atribut për një person që nuk kupton, përkatësish nuk flet arbërisht, përkatësish që nuk i përket bashkësisë gjuhësore arbëreshe.

Nga sa përmblodhëm dhe klasifikuam më sipër, mund të vërejmë fillimisht që shenjuesi shqa, gjithkund ku gjëllin ndër shqiptarë: në hapësirën e sotme kompakte shqipfolëse, dhe/ose ndër arvanitë e arbëreshë në diasporën historike në Greqi dhe në Italinë e Jugut, ngërthen në vetvete një tufë tiparesh identifikuese, ndër to tiparin a) etnik-gjenetik, b) gjuhësor, c) fetar, d) zakonor-tradicional, si edhe atë e) (ndërkohë të rrëgjuar) social-ekonomik. Këto tipare, në bashkëveprim me njëri tjetrin e në bashkëvajtje me faktorët kohë dhe hapësirë, sendërtojnë entitete të ndryshme etnike-kulturore, ndër të cilat dallojmë: geg. + tosk. ver. “sllav (i jugut)”, përkatësish degëzimet (e mëvonshme): geg. ver.per. “malazias”, geg. ver.lind. “serb”, geg. jug. + tosk. ver. “maqedon(-bulgar)”, më tej arb. Gr. “grek njëgjuhësh/jo-arvanit”, dhe arb. It. “jo-arbëresh”.

Secili entitet etnik-kulturor – ashtu siç qartësohet më lart në dy grupimet kryesore (A, B) me nënndarjet (nr. 1 deri 6) dhe degëzimet përkatëse ( $\alpha/\beta$ ) – karakterizohet me të paktën një tipar identifikues (pikat 4/ $\beta$ , 5, 6), ose dëshmon bashkëpërkime të dy ose më shumë tipareve, në kuptimin që ato entitete sendërtojnë së bashku një tufë tiparesh identifikuese të qëndrueshme (pikat 1, 2, 4/ $\alpha$ ). Është pikërisht kjo larmi entitetesh që lejon në të njëjtën kohë vetë qëmtimin e asaj tufe tiparesh identifikuese, por të përkundërt, të cilat karakterizojnë shqiptarët, duke u veçuar kështu si entitet etnik-kulturor i mëvetësishëm në hapësirën e tyre kompakte në Ballkan, por edhe në diasporën historike shqiptare.

Në rast se vijojmë tash analizën mbi këtë premisë metodike, do të mund të përsiasim pa vështirësi, se shenjuesi shqa ndër shqiptarë (A/1-4) sendërtohet idealisht me anë të kombinimit të një numri tiparesh identifikuese të përkundërt, e pikërisht:

tjetër origjinë/prejardhje: “sllave (jugore)” >< “shqipe”.

tjetër gjuhë burimore: “sllavishte” (në kuptimin e gjerë të fjalës) >< “shqipe”.

tjetër besim/konfesion: “ortodoks-sllav” >< “katolik / ortodoks shqiptar / muhamedan”, e në bashkëlidhje me këtë:

(pjesërisht) tjetër traditë në mënyrën e jetesës, të drejtën zakonore, përkatësisht në konceptimin e vlerave njerëzore: “sllave” >< “shqiptare”; si edhe:

tjetër trashëgimi kulturore/kulturë shkrimore: “sllave” >< “shqipe”; ndërkohë që:

ndajnë një hapësirë jetike të përbashkët / kufitare: “shqiptar” ~ “sllav (i jugut)” [= “popuj fqinjë”].

Sqarime:

Prej kësaj tufëze tiparesh identifikuese mund të veçojmë origjinën dhe gjuhën burimore (pikat a, b) si tipare konstitutive të qëndrueshme, d.m.th. gjithherë të pranishme në kohë dhe hapësirë.

Tipari identifikues: [tjetër besim/konfesion] (pika c) mëton po ashtu statusin e tiparit konstitutiv, ky sidomos të paktën për periudhën deri në gjysmën e dytë të shek. IX, kur sllavët e jugut – ndryshe nga shqiptarët – nuk kishin përkrahur ende kristianizmin. Por edhe mbas kësaj periudhe, sidomos përgjatë dhe pas mesjetës së vonë, erdhën dhe u ravigjëzuan brenda këtij tipari nuancime tipike shqiptare (khs. Bogdani 1685: *<arbanaska vera>* = “feja arbëreshe”), të cilat vijojnë edhe sot e gjithë ditën, por në një kontekst të ndryshëm social-kulturor, khs.: [shqiptar] = “katolik-romak/ortodoks-shqiptar/muhamedan” ~ [sllav (i jugut)] = “ortodoks-sllav”.

Një situatë të ngjashme mund të përsiasim edhe për pikat d) dhe e), edhe pse në traditën jetësore, në trashëgiminë e kulturës popullore si edhe në konceptimin e vlerave njerëzore janë përfstuar me kohë në rrrafsh ballkanik shumë pika takimi. Në këtë qerthull lejohemi të ngërthejmë edhe arealin dialektor të toskërishtes jugore, po qe se do të marrim parasysh praninë e çerdhes leksikore përkatëse dhe historinë e kontaktive të dikurshme ndëret-nike në këtë zonë.

Grupimi i dytë (B/5-6) ngërthen entitete, që në kohën tonë nuk kanë kurrrfarë lidhjesh me grupimin e parë (A/1-4). Bëhet fjalë këtu: a) në radhë të parë me përshtatjen e shenjuesit shq. në një mjedis tjetër etnik-kulturor dhe gjuhësor; si edhe b) për bashkësi shqipfolëse që ka bjerrë prej më se pesë deri shtatë shekujsh kontaktet e ndërsjella intensive me hapësirën jetike kompakte shqiptare në Ballkanin Perëndimor dhe Qendror. Në këtë rast do mbajtur parasysh edhe rrudhja e tipareve identifikuese që sendertojnë gjuhësisht nocionin shq. në të dyja diasporat. Kështu p.sh. tek arvanitasit e Greqisë dhe – po të mbajmë parasysh çerdhen leksikore ekzistuese – tek arbëreshët e Italisë së Jugut shq. shenjon në thelb një person: me një tjetër gjuhë burimore: “jo-arvanit”, përkatësisht “jo-arbëresh”, e përrjedhojë:

me tjetër origjinë: “jo-arvanit”, përkatësisht “jo-arbëresh”.

Këto dy tipare identifikuuese ruajnë në vetvete vlera të ngjashme edhe për pjesën tjetër të diasporës shqiptare (§ 2.2); madje në këndvështrimin antropologjik, ato mund dhe duhen vështruar si njëloj të vlefshme me dy tiparet identifikuuese themelore në matriksin e kulturës etnike të popullit shqiptar në hapësirën e tij kompakte në Ballkanin Perëndimor dhe Qendror; e këto janë origjina dhe gjuha burimore. Këto tipare sendërtojnë pra gjithherë – në kohë dhe hapësirë – në bashkëlidhje të ndërsjellë qoftë vetëm me njëri-tjetrin, qoftë në kombinim me tipare të tjera identifikuuese, shtyllat mbështetëse për të gjitha elementet konstitutive, të cilët lejojnë të vendosim sipas rastit dhe rrethanave vizat paralele midis nacioneve “shqa” = “jo-shqiptar”.

#### 4. Përfundim

Nga sa u parashtrua më sipër, vijmë në përfundimin që hetimi gjuhë-sor-diakronik i shenjuesit shqa mundëson për nga perspektiva etnolinguistike ngadhënjimin e njohurive të reja mbi forcën e veprimit të kulturës etnike-gjuhësore, që tejbartën shtegtarët sllavë në shek. VI – VII në ngulimet e tyre të reja në Gadishullin Ballkanik, duke e zhvilluar atë më tej përgjatë mesjetës e më vonë deri në diferencimin dhe ngjizjen e etnogjenezave të reja sllave (jugore). Gjithsesi, në fazën e parë të këtij veprimi, bash nën rezikun kërcënues të zhbërjes kulturore-etnike të gjithë Ballkanit, rezulton të ishte ngjizur ndërkohë vetë etnogjeneza shqiptare, në të cilën krahas origjinës dhe gjuhës burimore ishte edhe besimi ai që fitoi statusin e tiparit konstitutiv kulturor-etnik.

Po të mbajmë parasysh këto tipare dalluese, që erdhën e u thelluan në kohë dhe hapësirë midis kulturave etnike përkatëse, nuk kemi përsë bëjmë më “çudi” as me përdorimin e këtij etniku për të shenjuar fqinjin “jo-arvanit” ndër arvanitasit e Greqisë, apo atë “jo-arbëresh” ndër arbëreshët e Italisë së Jugut. Shenjuesi shqa ndër shqiptarë, të paktën në periudhën para shpërndarjeve arvanite drejt jugut të Greqisë dhe Peloponezit (shek. XIII), përballej ndërkohë me një ridimensionim konceptual, duke dalluar pikërisht “fqinjin” tjetër, d.m.th. jo-shqiptar.

#### Bibliografi

##### Burimet:

- Ahmetaj, M., Fjalor i të folimeve shqiptare në Mal të Zi. Prishtinë 1996.
- Ahmetaj, M., E folmja e Plavës dhe e Gucisë. Prishtinë 2002.
- Arbanas, L., Deutsch-Albanisches und Albanisch-deutsches Wörterbuch. Wien, Leipzig 1912.
- Barić, H., Rečnik srpskoga ili hrvatskoga i arbanskoga jezika, Bd. I. Zagreb 1950.
- Bartoli, M.: Das Dalmatische, bl. I-II, Wien 1906I (19732).

- Bashkimi-Shoq.: Fjaluer i Rii i Shcpés. Përbâam Préie Shocniét Bashkimit. Shkodër 1908 (Prishtinë 1972).
- Battaglia: Grande Dizionario della Lingua Italiana, (t. XVII), Torino 1994.
- Blanchus, Fr. [= Frang Bardhi], Dictionarium latino-epiroticum. Romæ 1635.
- Bogdani, P., Cvnevs Prophetarum de Christo Salvatore Mvndi, et eivs Evangelica Veritate; italicice, et epirotice contexta; Et in duas Partes divisa a Petro Bogdano macedone [...]. Patavini 1685.
- Chetta, N. [= Nikollë Keta], Lessico italiano-albanese (Ms. 1763).
- Cordignano, P. Fulvio, Dizionario Albanese–Italiano e Italiano–Albanese. Parte Albanese–Italiana. Milano 1934.
- Dictionarul Limbii Române, t. XI. Bucureşti 1978.
- Fjalor enciklopedik shqiptar. Tiranë 1985. (= FESH).
- Fjalori i gjuhës shqipe. Tiranë 1954 (= FGJSH).
- Fjalor i gjuhës shqipe. Tiranë 2006 (=FGJSH).
- Fjalor i shqipes së sotme. Tiranë 1984, 22002 (= FSHS).
- Giordano, E., Fjalor i arbëreshëve të Italisë - Dizionario degli albanesi d'Italia. Bari 1963.
- Guagliata, Z., Dottrina e Kerscten Cardinàlit Bellarmino t'sciochnièt Jesus, Rom 1845, 21856.
- Hahn, J. G., Albanesische Studien. Heft 3. Beiträge zu einem albanisch-deutschen Lexikon. Wien 1854.
- Haxhillazi, P. / Ahmeti, S. B., Fjalor i shqipes së Plavës dhe të Gucisë. Tiranë 2004.
- Islami, S., Matériel linguistique des colonies albanaises d'Ukraine, Studia albanica 2 (1965), 165-187.
- Jochalas, T., EYBOIA. Ta Αρβανίτικα. Athen 2002.
- Jochalas, T., Υδρα. Λησμονημένη γλώσσα, Bd. I. Athen 2006.
- Jungg, G.: Fialur i voghel sccyp e Itinisct. Sckoder 1895.
- Kuvendi i Arbënët: Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit. Mbelieçune nde viett gnai mijë sctat cint e tre ndene Clementit i Gnimijetmi Pape Pretesa. Rom 1706 (Prishtinë 20032).
- Kristoforidhi, K., Fjalor shqip-greqisht. Athen 1903 (Tiranë 19612).
- Krstić, K., Rječnik Govora Zadarskih Arbanasa. Zadar 1987.
- Leotti, Angelo, Dizionario Albanese-Italiano. Roma 1937.
- Lessico Universale Italiano, bl. 20. Roma 1978 (= LUI).
- Mann, S. E., An Historical Albanian-English Dictionary. London, New York, Toronto 1948.
- Murati, Q., Fjalor i shqipes trualsore të Maqedonisë. Tetovë 1998.
- Murati, Q., Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë. Shkup 2003.
- Mysliu, S./Dauti, D., Shqiptarët e Ukrainës. Shkup 1996.
- Papahagi, T., Dictionarul dialectului aromân, Bucureşti 1963.
- Radoja, E., Dotrinna e Kerscten. N'Sckoder 1876.
- Reinhold, Th., Noctes pelasgicae. Athen 1954 (Lexikon-Teil).
- Sasse, H.-J., Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland, Teil I. Wiesbaden 1991.
- Shuteriqi, Dh., Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë, Studime Filologjike 2 (1965), 153-170.
- Sokolova, Bojka, Die albanische Mundart von Mandrica. Berlin 1983.
- Tagliavini, C., L'albanese di Dalmazia. Firenze 1937.
- Tase, P., Fjalorth i Ri. Fjalë të rralla të përdoruna në jug të Shqipnis. Tiranë 1941.
- Truhelka, Č., Deutsch-albanisches Wörterbuch. (Bot. M. Ahmeti) Zagreb 1995 [- Ms. 1899].
- Weigand, G., Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch. Leipzig 1914.

## Bardhyl Demiraj: Kur etnikët tregojnë: shqqa,-u ndër shqiptarë.

- Windisch, von: Von den Klementinern in Sirmien, në: Ungrisches Magazin, Bd. 2., Preßburg 1782.
- Literaturë shkencore
- Altimari, F., Alcuni etnici di origine albanese nei dialetti di Calabria, in: "Scripta minora albanica", në serinë: Quaderni di Zjarri, Rende 1994 (1992), 47-57.
- Buda, A., Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë, në: "Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij". Tiranë 1988, 15-31.
- Curta, Florin, The Making of the Slavs. History and Archaeology of the Lower Danube Region, c. 500–700. Cambridge 2001.
- Demiraj, Bardhyl, Aktet e "Kuvendit të Arbënit" dhe rëndësia e tyre në studimet albanologjike, në: "Das albanische Nationalkonzil 1703. Kulturwissenschaftliche Tagung zu seinem 300. Jubiläum. München, 13. September 2003". (Bot. Bardhyl Demiraj) Prishtinë 2004, 70-87.
- Demiraj, Bardhyl, "Shqiptar", në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë 2005, 105-137.
- Demiraj, Sh., Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë 1985.
- Demiraj, Sh., Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe. Tiranë 1999.
- Elsie, Robert, Histori e letërsisë shqiptare. Prishtinë 21997.
- Hahn, J. G. v., Albanesische Studien, bl. III. Jena 1854.
- Gjinari, Jorgji, Dialektet e gjuhës shqipe. Tiranë 1989.
- Ismajli, R., Cguha shqipe e kuvendit të Arbënit (1706). Prishtinë 1985.
- Ismajli, R., Etmi dhe modernitet. Prishtinë 1991.
- Jireček, K., Albanien in der Vergangenheit, në: Illyrisch-albanische Forschungen, Bd. 1. Hg. Ludwig von Thallótzy. München, Leipzig 1916, 68-93.
- Jochalas, T., Die Einwanderung der Albaner in Griechenland, në: Dissertationes Albanicae (Red. Peter Bartl) München 1971, 89-106.
- Kahane, H. & R., Notes on the Linguistic History of Slavus, në: Studi in onore di Ettore lo Gatto. Firenze 1962, 345-360.
- Korth, G. v., Zur Etymologie des Wortes "Slavus" (Sklave), në: Glotta 48 (1970), 145-53.
- Meyer, G., Etymologisches Wörterbuch der albanischen Sprache. Straßburg 1891.
- Mihăescu, H., La langue latine dans le sud-est de l'Europe. Bucureşti 1978.
- Miklosich, K., Die slavischen Elemente im Albanischen. Wien 1870.
- Orel, Vladimir, Albanian Etymological Dictionary. Leiden, Boston, Köln 1998.
- Skok, Petar, Etimologjiski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika, bl. III. Zagreb 1973.
- Skok, Petar, Slave et albanais, në: "Arh. Arb. Star." 2 (1924), 107-126.
- Svane, G., Slavische Lehnwörter im Albanischen. Aarhus 1992.
- Vasmer, M., Die griechischen Lehnwörter im Serbo-Kroatischen. Berlin 1944.
- Vasmer, M., Russisches etymologisches Wörterbuch. 3 Bde. Heidelberg 1953-1958.
- Vătășescu, C., Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna. Bucureşti 1997.
- Ylli, Xh., Das slavische Lehngut im Albanischen, 1. Teil. München 1997 (Slavistische Beiträge, 350).

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München

## WHAT DENOMINATIONS INDICATE: SHQA-U AMONGST ALBANIANS

### Summary

This study contains the inner history of one of the earliest ethnic names in Albanian onomastic nomenclature. It is a question of the foreign denomination shqa-u, pl. shqe-të which is present even nowadays in informal speech and its meaning is "(southern) Slav; Slavic-speaking". It seems that this denomination at least from the second part of the last century has not been included as a special term in glossaries or Albanian glossaries in two languages.

The valuable treasure of formal variants and semantic nuances within different dialectal variants of this term enables the author to qualify it as an orientation element in retrospective reconstruction of previous phases that have characterized the process of creation and development of Albanian ethnogenesis.